



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.331/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziq dhe rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e Bekim Ademi, nga Lëvizja për Drejtësi (LDK-AKR), dega në Kamenicë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR për shkak të manipulimit të votave brenda koalicionit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pasafatshme ankesat e Bekim Ademit nga Lëvizja për Drejtësi-Koalicioni LDK-AKR- dega në Kamenicë, me numër të ankesave Anr.331, Anr.332, Anr.333, Anr.334, Anr.335, Anr.336 dhe Anr.337 të datës 13.06.2017 të parashtruara kundër Koalicionit LDK-AKR-dega në Kamenicë

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat Anr. 331/2017, Anr. 332/2017, Anr. 333/2017, Anr. 334/2017, Anr. 335/2017, Anr. 336/2017, Anr. 337/2017, të datës 14.06.2017, dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me Anr. 331/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Me datën 13.06.2017, PZAP-i ka pranuar shtatë ankesa nga Bekim Ademi anëtar i këshillit zgjedhor pranë LDK-AKR, Lëvizja për Drejtësi, në të cilat pretendon se janë bërë manipulime të votave brenda koalicionit LDK-AKR. Parshtruesi i ankesave thekson se numri i votave të cilët kanë dalur nga regjistrat e KQZ-së, respektivisht në kutitë e KQZ-së, nga procesi i ditës së votimit me datën 11.06.2017 dhe numri është i përgjysmuar i votave të regjistruara në krahasim me numrin e fletvotimeve të cilat gjenden në kutinë e votimit.

Me këtë rast parshtruesi i ankesave kërkon nga organet kompetente të bëhet rinumërimi i Votave.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 331/2017 për r shkak të natyrës së njejtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për shtatë ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave gjeti se:

Ankesat janë të pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5.3 të Rregullorës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesat të njëjtat janë dorëzuar në PZAP, nga parashtruesit e ankesave me datë 13.06.2017. Nga përmbajtja e ankesave rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruar nga ankuesit në ankesat Anr.331/2017, Anr.332/2017, Anr.333/2017, Anr.334/2017, Anr.335/2017, Anr. 336/2017 dhe Anr.337/2017 të datës 13.06.2017, ndërlihen me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në ditën e votimit të datës 11.06.2017.

Nga kjo rezulton se ankesat e lartpërmendur janë dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjore për të parashtruar ankesa në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesit ankesat e tyre i kanë parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullorës Nr.02/2015, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.331/2017 më datën 14.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.